



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P - 75
Prishtinë, më 7 shtator 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 7 SHTATOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 98 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Ai procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, të plotësuar me pikën: Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuara nga Qeveria dhe
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

1. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuara nga Qeveria

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Kosovës, në pajtim me nenin 144 paragrafi 1 të Kushtetutës ka propozuar amendamentimin e Kushtetutës, që ka të bëjë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Amendamentet e propozuara, kryetari i Kuvendit ia kishte adresuar Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse të njëjtat pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në kapitullin II të Kushtetutës.

Komisioni ad hoc për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës i kishte shqyrtuar amendamentet kushtetuese, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, të propozuara nga Qeveria e Kosovës, si dhe e kishte vlerësuar të pranueshëm vendimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me vlerësimin e amendamenteve të propozuara.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që të marrë fjalën.

Zv. kryeministri dhe ministër i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, tha se sot po e shënojmë një kapitull përfundimtar drejt miratimit të amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Kosovës, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të cilat janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe nga Komisioni ad hoc për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ai në vazhdim këto ndryshime kushtetuese i vlerësoi në radhë të parë si rezultat i pjekurisë së popullit të Kosovës dhe të institucioneve shtetërore në Republikën e Kosovës.

Më tej, zv.kryeministri Kuçi u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e amendamenteve kushtetuese të propozuara, për të cilat tha se janë gjithsej 22 sosh, duke sqaruar se amendamenti nr. 17, që ka të bëjë me nenin 156 të Kushtetutës, bartet në Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim të amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arsim Bajrami - në emër të Komisionit ad hoc për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët se duke u bazuar në nenin 144, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e 2/3-ve të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dhe 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, që nuk janë shumicë në

Republikën e Kosovës, që do të thotë se nevojiten 80 vota, përfshirë këtu 14 vota të komuniteteve të tjera.

Më pas tha se në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare votimi i amendamenteve do të bëhet në pako me një votim, përfshirë këtu propozimin e Komisionit për amendamentin 17, që do të bartet në kapitullin e dytë të Kushtetutës.

Kryetari kërkoi edhe një herë nga deputetët që para se të hyhet në procedurën e votimit, të deklarohen me votim elektronik për praninë e tyre në mbledhje. Të pranishëm u deklaruan 110 deputetë.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuara nga Qeveria, përfshirë këtu propozimin e Komisionit për amendamentin 17, që do të bartet në kapitullin e dytë të Kushtetutës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 98,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se për kanë votuar 98 deputetë, ndërsa nga komunitetet jo shumicë kanë votuar 22 deputetë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohen ndryshimet kushtetuese që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Kosovës.
2. Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqes dhe ta arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Zv.kryeministri dhe ministër i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, tha se ky Projektligj ratifikon Marrëveshjen ndërkombëtare të arritur nëpërmjet shkëmbimit të instrumenteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Në vazhdim, ministri Kuçi theksoi se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare bëhet pa u kufizuar nga:

1. Zgjatja e mandatit të EULEX-it në fushat e parapara në marrëveshje deri më 15 qershor 2014 dhe me përjashtim të Task Forcës Hulumtuese Speciale.
2. Delegimi i autoritetit për propozimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në përputhje me Kushtetutën, neni 20, dhe krijimi i një kuadri për formimin e një sistemi të regjistrimit për stafin e EULEX-it që i lejohej armëmbajtja.
3. Garantimi i imunitetit të stafit të zyrës së personelit të EULEX-it si dhe Përfaqësuesit Special të BE-së ("EUSR"), në bazë të Ligjit nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake, si dhe personelin e saj.

Në fund, ministri Kuçi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 97,
Kundër ----- 11,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr.04/L-148 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX).

Kryetari i deklaroi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale